

D E K R E T
Nr.1350, datë 10.1.1996

PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE”

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në dekretin nr.7393, datë 12.6.1990 “Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave”, me ndryshimet përkatëse, në nenin 17, dy paragrafët e fundit ndryshohen si vijon:

“Shtetasit e Zvicrës, Austrisë, Finlandës, Suedisë, Norvegjisë, Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Spanjës, Francës, Irlandës, Italisë, Luksenburgut, Holandës, Portugalisë, Britanisë së Madhe, Greqisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bullgarisë, Kanadasë, Turqisë, Australisë, Japonisë, Zelandës së Re, Singaporit, Koresë së Jugut kanë të drejtë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë nevoja të pajisen me vizë.

Të drejtën e mësipërme e kanë për reciprocitet edhe shtetasit e atyre shteteve që nuk kërkojnë të pajisin me vizë shtetasit shqiptarë, kur këta të fundit hyjnë në territorin e tyre”.

Neni 2

Në nenin 18, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Shtetasit e Zvicrës, Austrisë, Finlandës, Suedisë, Norvegjisë, Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Spanjës, Francës, Irlandës, Italisë, Luksenburgut, Holandës, Portugalisë, Britanisë së Madhe, Greqisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bullgarisë, Kanadasë, Turqisë, Australisë, Japonisë, Zelandës së Re, Singaporit dhe Koresë së Jugut paguajnë një taksë për hyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila caktohet me dispozita të veçanta”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi më 11.1.1996.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar nga Kuvendi Popullor me ligjin nr.8066, datë 8.2.1996